MINISTRIA E DREJTËSISË

TETOR 2026

BULETINI INFORMATIV

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

NJË DERË E RE PËR TË SJELLË DREJTËSINË MË PRANË NJERËZVE



Ministri i Drejtësisë, z. Toni Gogu, inaguroi Qendrën e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Falas në Fushë Krujë. Kjo Qendër synon të zgjerojë aksesin në shërbimet juridike falas për mbi 51 mijë banorë të Bashkisë Krujë. Prioriteti i Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas mbetet sigurimi i drejtësisë për çdo qytetar.

BASHKËPUNIM I NGUSHTË ME AUSTRINË PËR REFORMËN NË DREJTËSI



Me pjesëmarrjen e Zëvendës Ministres së Drejtësisë, znj. Elona Hoxha dhe Drejtoreshës së Përgjithshme (të komanduar) të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, znj. Patricia Pogaçe, u zhvillua një takim me delegacionin përfaqësues të Qeverisë Federale Austriake, të shoqëruar nga gazetarë të mediave televizive dhe radiofonike austriake, ku u diskutua mbi reformën në drejtësi dhe prioritetet në kuadër të angazhimit Evropian.

DËGJESË PUBLIKE ME QYTETARËT E NJËSISË ADMINISTRATIVE NR. 10



Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas zhvilloi një dëgjesë publike me qytetarët e Njësisë Administrative Nr. 10 në kryeqytet. Qëllimi i dëgjesës ishte informimi i qytetarëve mbi të drejtën për të përfituar ndihmë juridike falas dhe adresimin e problematikave ligjore të komunitetit.

TAKIM KOORDINUES ME ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE TË FINANCUARA NGA DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS



Drejtoresha e Përgjithshme (e komanduar) e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, znj. Patricia Pogaçe, zhvilloi një takim koordinues me përfaqësues të Organizatave Jofitimprurëse të Financuara, me të cilat u diskutua mbi ecurinë e zbatimit të projekteve, rezultatet e arritura dhe sfidat e hasura gjatë realizimit të aktiviteteve.

INFORMIMI DHE MBROJTJA E TË DREJTAVE NË MOMENTIN E PARË

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas vendosi juristët e saj pranë Komisariateve të Policisë së Shtetit në Tiranë, për të ofruar këshillim ligjor, informimi dhe orientim falas, duke garantuar mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të tyre.



TAKIM KOORDINUES ME AVOKATË TË ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE

Drejtoresha e Përgjithshme (e komanduar) e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, znj. Patricia Pogaçe, zhvilloi një takim koordinues me avoaktë dhe përfaqësues të Organizatave Jofitimprurëse në kuadër të nismës për garantimin e aksesit në mbrojtje ligjore falas për të miturit dhe të rinjtë në konflikt me ligjin.



INTERVISTË RADIOFONIKE PËR EMISIONIN "LIGJ ME DREJTËSI"



Koordinatorja për të Drejtën e Informimit të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, znj. Helga Çela, ishte pjesë e emisionit radiofonik "Ligj me drejtësi", nën moderimin e znj. Blerina Hamzollari. Së bashku iu përgjigjën pyetjeve të qytetarëve, si dhe ndanë informacionin e nevojshëm mbi Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Falas.



QSHNJP Përmet, në datën 01.10.2026, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të të Moshuarve, zhvilloi një aktivitet "Street Law", me fokus informimin e qytetarëve të moshuar mbi të drejtat e tyre dhe mundësitë e përfitimit të ndihmës juridike falas.



QSHNJP Përmet, në datën 02.10.2026, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare Pa Dhunë, zhvilloi një takim informues në Njësinë Administrative Piskovë.



QSHNJP Përmet, në datën 21.10.2026, zhvilloi një takim me Drejtoreshën dhe specialistet e AKPA-së, me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional për identifikimin dhe referimin e qytetarëve që kanë nevojë për ndihmë juridike falas.



QSHNJP Përmet, në datën 30.10.2026, në kuadër të veprimtarive informuese dhe ndërgjegjësuese në shkolla, zhvilloi një aktivitet në shkollën 9-vjeçare "Nonda Bulka", në bashkëpunim me Shërbimin e Provës dhe psikologen e shkollës.



QSHNJP Durrës, më 21.10.2026, mori pjesë në aktivitetin përmbyllës të projektit të zbatuar nga Qendra Equilibrium, me fokus mbështetjen dhe riintegrimin social e profesional të të rinjve.

QSHNJP Durrës, më 27.10.2026, mori pjesë në takimin e organizuar nga Fondacioni "Së Bashku" për shkëmbimin e praktikave mbi vendimmarrjen e mbështetur dhe njohjen e barabartë para ligjit për personat me aftësi të kufizuara.



QSHNJP Durrës, më 27.10.2026, mori pjesë në takimin e Grupit të Aktorëve Lokalë për koordinimin e identifikimit, referimit dhe trajtimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe të dhunës në familje, pranë Qendrës së Shërbimit Social Durrës.



QSHNJP Dibër, më 05.10.2026, mori pjesë në tryezën e organizuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ku u diskutua mbi diskriminimin në punësim, aksesin në mbrojtjen sociale dhe mundësitë e mbështetjes për familjet në vështirësi ekonomike.

QSHNJP Fier, më 01.10.2026, në bashkëpunim me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, informoi dhe këshilloi të moshuarit mbi të drejtat ligjore, shërbimet e ndihmës juridike falas dhe kategoritë përfituese.



QSHNJP Fier, më 02.10.2026, mori pjesë në prezantimin e projektit "2 Orë për Veten – 2 Orë për Ne", duke kontribuar në bashkëpunimin për informimin dhe fuqizimin e familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara.



QSHNJP Fier, më 05.10.2026, në bashkëpunim me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, informoi dhe këshilloi të moshuarit e Qendrës Ditore "Kafe me Gjyshin" mbi të drejtat ligjore dhe mundësitë e përfitimit të ndihmës juridike falas.



QSHNJP Fier, më 02.10.2026, zhvilloi takim informues me qytetarë me aftësi të kufizuara në Bashkinë Patos, duke i orientuar mbi të drejtën, kriteret dhe mënyrat e përfitimit të ndihmës juridike falas.

QSHNJP Fier, më 06.10.2026, në bashkëpunim me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, zhvilloi takim pune me Kryetarin e Bashkisë Mallakastër për forcimin e bashkëpunimit institucional dhe referimin e qytetarëve që kanë nevojë për ndihmë juridike falas.





QSHNJP Fier, më 12.10.2026, në bashkëpunim me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, zhvilloi aktivitet informues mbi të drejtën për ndihmë juridike falas dhe mundësitë e barabarta për zhvillim profesional të vajzave dhe grave, pranë Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik Fier.



QSHNJP Fier, më 27.10.2026, mori pjesë në Ditën e Hapur të organizuar nga Avokati i Popullit, ku u dëgjuan problematikat e qytetarëve dhe u diskutua për adresimin e tyre përmes bashkëpunimit institucional.




QSHNJP Fier, më 28.10.2026, mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në kuadër të nismës "Udhëtimi në Shqipëri", ku u trajtuan barazia në marrëdhëniet e punës dhe vështirësitë e personave me aftësi të kufizuara.



QSHNJP Fier, më 29.10.2026, në bashkëpunim me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, zhvilloi takim informues mbi të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, trajtimin e barabartë dhe mbrojtjen nga diskriminimi.



QSHNJP Fier, më 30.10.2026, mori pjesë në trajnimin e organizuar nga Qendra për Advokim Social për forcimin e përfshirjes sociale, bashkëpunimit vendor dhe mbrojtjes nga diskriminimi të komuniteteve Rom dhe Egjiptian.



QSHNJP Gjirokastër, më 05.10.2026, mori pjesë në takimin e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit për vlerësimin e nevojave të viktimës së dhunës në familje dhe përcaktimin e masave të mbështetjes, përfshirë ndihmën juridike falas.

QSHNJP Gjirokastër, më 07.10.2026, mori pjesë në mbledhjen e Grupit Teknik Ndërsektorial për këshillimin dhe orientimin e viktimës së dhunës në familje dhe koordinimin e mbështetjes juridike e sociale.



QSHNJP Gjirokastër, më 08.10.2026, mori pjesë në workshop-in e organizuar nga UNHCR, Policia e Shtetit dhe EUAA mbi mekanizmat e referimit, vlerësimin e cenueshmërisë dhe bashkëpunimin ndërinstitucional për personat që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare.



QSHNJP Gjirokastër, më 22.10.2026, zhvilloi një intervistë për median Vizion Plus mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti dhe personat që përfitojnë akses në drejtësi.

QSHNJP Gjirokastër, më 29.10.2026, mori pjesë në inaugurimin e ambienteve miqësore për fëmijët pranë Zyrës Përmbarimore, një nismë që synon krijimin e një mjedisi të sigurt dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve.





QSHNJP Kavajë, më 06.10.2026, zhvilloi takim me përfaqësuesen e Postës Shqiptare, shpërndau broshura informuese për qytetarët dhe afishoi postera në Pallatin e Kulturës “Mustafa Krantja”.



QSHNJP Kavajë, më 26.10.2026, në bashkëpunim me Fondacionin “Së Bashku”, zhvilloi aktivitet ndërgjegjësues mbi mundësitë e përfitimit të ndihmës juridike falas nga personat me aftësi të kufizuara.



QSHNJP Korçë, më 01.10.2026, në bashkëpunim me strukturat vendore dhe institucionet partnere, zhvilloi aktivitet informues për promovimin e të drejtave të të moshuarve dhe orientimin e tyre drejt shërbimeve mbështetëse.



QSHNJP Korçë, më 09.10.2026, në bashkëpunim me Shërbimin Social dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, informoi nxënësit mbi të drejtat e vajzave, mundësitë e barabarta dhe mbrojtjen nga diskriminimi e dhuna.



QSHNJP Korçë, më 15.10.2026, zhvilloi aktivitet ndërgjegjësues mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në shikim dhe rëndësinë e aksesueshmërisë, pavarësisë dhe përfshirjes së tyre në shoqëri.



QSHNJP Korçë, më 19.10.2026, mori pjesë në emisionin e mëngjesit të RTSH Korça për të informuar publikun mbi shërbimet e ndihmës juridike falas.



QSHNJP Korçë, më 22.10.2026, mori pjesë në mbledhjen e Grupit Teknik Ndërsektorial, duke kontribuar në diskutimet për garantimin e të drejtave të të miturit dhe mundësitë e përfitimit të ndihmës juridike.



QSHNJP Korçë, më 25.09.2026, mori pjesë në mbledhjen e Grupit Teknik Ndërsektorial për vijimin e trajtimit të rastit të një të mituri që nuk frekuenton shkollën dhe shfaq sjellje problematike.



QSHNJP Korçë, më 30.10.2026, në bashkëpunim me Drejtorinë e Kujdesit Social, informoi nxënësit mbi të drejtat ligjore dhe mundësitë e përfitimit të ndihmës juridike falas.



QSHNJP Kukës, më 13.10.2026, mori pjesë në takimin e hapur të Avokatit të Popullit, ku u dëgjuan shqetësimet dhe ankesat e qytetarëve lidhur me veprimtarinë e institucioneve publike dhe respektimin e të drejtave të tyre.



QSHNJP Kukës, më 22.10.2026, zhvilloi takim me përfaqësues të Bashkisë Kukës dhe IOM-it për prezantimin e shërbimeve të ndihmës juridike dhe forcimin e bashkëpunimit për referimin e qytetarëve.



QSHNJP Kukës, më 30.10.2026, informoi të moshuarit mbi shërbimet e ndihmës juridike falas, kategoritë përfituese dhe mënyrat e aksesimit, duke trajtuar edhe problematika që lidhen me pensionet dhe përfitimet sociale.



QSHNJP Kurbin, më 29.10.2026, në bashkëpunim me Zyrën Rajonale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi Shkodër, informoi të moshuarit mbi të drejtat e tyre, mekanizmat e mbrojtjes nga diskriminimi dhe mundësitë e përfitimit të ndihmës juridike falas.

QSHNJP Lezhë, më 09.10.2026, mori pjesë në takimin e organizuar nga Instituti për Ndryshim dhe Lidership në Shqipëri dhe organizatat partnere, ku u prezantuan nisma dhe histori të fuqizimit të grave në situatë vulnerabiliteti.






QSHNJP Lushnjë, më 14.10.2026, mori pjesë në aktivitetin e Bashkisë Lushnjë në kuadër të "Tetorit Rozë", duke mbështetur ndërgjegjësimin për parandalimin, diagnostikimin e hershëm dhe trajtimin e kancerit të gjirit.



QSHNJP Lushnjë, më 29.10.2026, zhvilloi aktivitetin "Street Law" në komunitet për informimin e qytetarëve mbi të drejtat ligjore dhe mundësitë e përfitimit të ndihmës juridike falas.



QSHNJP Elbasan, më 01.10.2026, zhvilloi aktivitetin "Street Law" në kuadër të Ditës Botërore të të Moshuarve, duke informuar të moshuarit mbi Ligjin nr. 111/2017, shërbimet dhe kategoritë përfituese.




QSHNJP Elbasan, më 06.10.2026, zhvilloi takim online me përfaqësues të bashkive të vogla për vijimin e bashkëpunimit institucional dhe referimin e rasteve që kanë nevojë për ndihmë juridike falas.



QSHNJP Elbasan, më 14.10.2026, zhvilloi takim me përfaqësuesen e Qendrës për Formim dhe Zhvillim për forcimin e bashkëpunimit dhe referimin e qytetarëve që kanë nevojë për ndihmë juridike falas.




QSHNJP Elbasan, më 14.10.2026, zhvilloi aktivitet informues pranë Bashkisë Gramsh mbi shërbimet e ndihmës juridike falas, kategoritë përfituese dhe mënyrat e aksesimit, duke vendosur edhe postera në institucione vendore.



QSHNJP Elbasan, më 15.10.2026, zhvilloi aktivitetin "Street Law" në kuadër të Ditës Botërore të Shkopit të Bardhë, duke informuar qytetarët mbi shërbimet e ndihmës juridike falas dhe kategoritë përfituese.



QSHNJP Elbasan, më 20.10.2026, informoi të moshuarit mbi të drejtat ligjore, shërbimet e ndihmës juridike falas dhe kategoritë përfituese, si dhe vendosi një poster informues në ambientet e qendrës.



QSHNJP Elbasan, mori pjesë në aktivitetin online të projektit "Rise Her – Fuqizojmë Gratë dhe Vajzat për një Jetesë të Pavarur", duke kontribuar në bashkëpunimin institucional për fuqizimin e grave dhe vajzave dhe promovimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas.



QSHNJP Elbasan, më 30.10.2026, zhvilloi një intervistë me gazetarin Fatmir Popja për informimin e publikut mbi veprimtarinë dhe shërbimet e ndihmës juridike falas.

QSHNJP Mat, më 01.10.2026, zhvilloi aktivitet sensibilizues me të moshuarit mbi përfshirjen sociale, mirëqenien emocionale dhe rëndësinë e njohjes së të drejtave të tyre.



QSHNJP Mat, më 01.10.2026, prezantoi shërbimin e ndihmës juridike falas pranë kursit "Kuzhinier", duke informuar pjesëmarrësit mbi aksesin e barabartë në drejtësi për personat që nuk kanë mjete financiare ose i përkasin kategorive të mbrojtura.



QSHNJP Mat, më 05.10.2026, mori pjesë në takimin e organizuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi për informimin mbi format e diskriminimit dhe mënyrat e raportimit të rasteve.



QSHNJP Mat, më 19.10.2026, zhvilloi takim me kryetarin e Shoqatës Kombëtare "Shpresë për të Verbërit" në Qarkun Dibër.

QSHNJP Shkodër, më 01.10.2026, zhvilloi takim informues me përfaqësues të Qendrës Rezidenciale të të Moshuarve për problematikat ligjore të kësaj kategorie dhe mundësitë e përfitimit të ndihmës juridike falas.





QSHNJP Shkodër, më 12.10.2026, mori pjesë në takimin e Komisionit Parlamentar KDNJMIP, ku u diskutua mbi rastet e trajtuara dhe problematikat e evidentuara gjatë trajtimit të tyre.



QSHNJP Shkodër, më 29.10.2026, në bashkëpunim me GADC, informoi punonjëset e fasonerisë "Melgushi" mbi të drejtat në vendin e punës, kontratat, kushtet e punës, procedurat e ankimit dhe ndihmën juridike falas.



QSHNJP Shkodër, zhvilloi një intervistë për RTSH-në për informimin e publikut mbi shërbimet dhe veprimtarinë e Qendrës.

QSHNJP Tiranë, më 05.10.2026, mori pjesë në trajnimin e organizuar në bashkëpunim me EU Migration për njohjen e kuadrit ligjor të migracionit dhe forcimin e mbështetjes për personat migrantë.



QSHNJP Tiranë, më 30.10.2026, afishoi postera informues në Gjimnazin "Sami Frashëri" për promovimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas dhe informimin e nxënësve mbi Ligjin nr. 111/2017.

QSHNJP Vlorë, më 01.10.2026, në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë, informoi të moshuarit mbi të drejtat e tyre dhe mundësitë e përfitimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.



QSHNJP Vlorë, më 12.10.2026, zhvilloi aktivitet informues për promovimin e të drejtave të vajzave të mitura, parandalimin e diskriminimit dhe dhunës dhe orientimin drejt ndihmës juridike falas.



QSHNJP Vlorë, më 12 tetor 2026, mori pjesë në takimin e organizuar nga Together for Life dhe Qendra "Rinore", ku u diskutua ndikimi i dezinformimit në vendimmarrjen mjekësore dhe shëndetin publik.



QSHNJP Vlorë, më 30 tetor 2026, zhvilloi takim informues me Shërbimin Social të Bashkisë Vlorë për prezantimin e shërbimeve, kritereve të përfitimit dhe forcimin e referimit të qytetarëve në nevojë.